



**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

RAPORT I PUNËS

Prishtinë, Mars 2021

**FJALA E KRYETARIT TË KËSHILLIT TË PAVARUR MBIKËQYRËS PËR
SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS, ESHREF SHABANI**

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë, që të prezentoj Raportin vjetor të punës së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2020. Ky raport, pasqyron aktivitetet e Këshillit në ushtrimin funksioneve kushtetuese dhe ligjore të tij.

Me lejoni t'iu njoftoj se Këshilli nga data 21.01.2019 e deri me datë 07.04.2020 ka mbetur vetëm me dy anëtarë, do të thotë pa kourum, ndërsa nga kjo datë deri më 08.10.2020 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ka mbetur pa asnjë anëtar të Këshillit, ndërsa ka funksionuar vetëm Sekretaria e KPMSHCK-së.

Andaj si rrjedhojë e kësaj situatë Këshilli është i detyruar që t'iu ofron pasqyrën e aktivitetëve të administratës së tij për tërë vitin 2020, si dhe aktivitetet e Këshillit në ushtrimin e funksioneve kushtetuese dhe ligjore për periudhën nga kur është funksionalizuar Këshilli e deri në fund të këtij viti, prandaj ky raport më tepër duhet të merret si raport informues se si raport përmbajtësor i punës së KPMSHCK-së.

Më këtë rast, falenderoj Sekretarin e pergjithshem, bashkëpunëtorët profesional dhe nëpunësit tjerë të sekretarisë, që kanë ofruar mbështetjen e tyre profesionale dhe administrative, si rezultat i së cilës kemi arritur që t'i realizojmë me sukses funksionet e Këshillit.

Eshref Shabani
Kryetar i KPMSHCK

TABELA E PËRMBAJTJES

FJALA E KRYETARIT TË KËSHILLIT TË PAVARUR MBIKËQYRËS PËR	2
SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS, ESHREF SHABANI	2
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
2. KORNIZA LIGJORE	5
3. FUSHËVEPRIMI I KËSHILLIT	5
4. ORGANIZIMI I KËSHILLIT	6
5. AKTIVITETET E KËSHILLIT PËR PËRIUDHËN RAPORTUESE	8
5.1. FUNKSIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE	8
5.1.1. Ankesat e pranuar sipas objektit të ankesës	9
5.1.2. Ankesat e ushtruara sipas strukturës gjinore të ankuesve	10
5.1.3. Ankesat e pranuar sipas strukturës etnike të ankuesve	11
5.1.4. Ankesat e pranuar sipas institucioneve kundër vendimeve të cilave është paraqitur ankesë	12
6. ANKESAT E PRANUARA KUNDËR VENDIMEVE TË INSTITUCIONEVE	13
6.1. Ankesat kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore	13
6.2. Ankesat e pranuar kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale	18
7. NDARJA E ANKESAVE SIPAS MËNYRËS SË VENDOSJES	20
7.1. Të aprovuara	20
7.2. Pjesërisht të aprovuara	20
7.3. Të refuzuara	20
7.4. Të hedhura poshtë si të palejuara	20
7.5. Të shpallura jo-kompetent	20
7.6. Detyrimi i organit administrativ për të nxjerr aktin administrativ	20
7.7. Kthimi në rishqyrtim	21
7.8. Përfundim i procedimit administrativ	21
8. FORMAT E VENDOSJES KUNDËR VENDIMEVE TË INSTITUCIONEVE	23
8.1. Format e vendosjes kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore	23
8.2. Format e vendosjes së ankesave kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale	25
9. ZBATIMI I VENDIMEVE TË KËSHILLIT NGA ORGANET E PUNËSIMIT	26
10. FUNKSIONI I MBIKËQYRJES SË PËRZGJEDHJES SË NËPUNËSVE TË NIVELIT TË LARTË DREJTUES DHE TË NIVELIT DREJTUES	29
11. FUNKSIONI I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL	29
12. REKOMANDIMET DHE SFIDAT E KËSHILLIT	30
13. VENDIMET E GJYKATAVE	30
14. BASHKËPUNIMI I KËSHILLIT ME INSTITUCIONET TJERA	32
15. KRAHASIMI I PUNËS SË KËSHILLIT PËR VITIN 2020 ME PUNËN E KËSHILLIT	32
PËR VITIN 2019	32
15.1. Funkcioni i shqyrtimit të ankesave	32
15.2. Funkcioni i monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil	33
16. RAPORTI PËR SHPENZIMIN E BUXHETIT TË KËSHILLIT	33

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i punës për vitin 2020, përmban të dhëna dhe informata të detajuara për të gjitha aktivitetet dhe punët e kryera nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Në raport përfshihen të dhëna lidhur me aktivitetet e kryera në kuadër të funksionit të shqyrtimit dhe vendosjes për ankesat e ushtruara nga nëpunësit civilë, ndërsa funksioni i monitorimit nuk ka mundur të ushtrohet për shkak të rrethaneve të ditura.

Po ashtu, në këtë Raport janë përfshirë edhe aktivitetet tjera të Këshillit të realizuara përmes sekretariatit, si përfaqësimi i Këshillit në procedura gjyqësore, lidhur me paditë e ushtruara kundër vendimeve të Këshillit.

Këshilli gjatë vitit 2020, ka pranuar gjithsejt 444 ankesa, si dhe ankesat që kanë qenë të bartura nga vitet paraprake (2018,2019, gjithsejt sosh 844 ankesa e që në tërësi Këshilli për shqyrtim ka pasur 1.288 ankesa gjatë fundvitit të 2020.

Këshilli pas emërimit të 5 (pesë) anëtarve nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës më datë 13.10.2020 ka mbajtur mbledhjen e tij konstitutive dhe veprimi i parë i tij ka qenë që ankesave që ishte duke ju skaduar afati për vendimmarrje ka vendosur konform dispozitave ligjore që këtyre ankesave tu zgjatet afati i vendimmarrjes edhe për 10 ditë.

Sfida kryesore e KPMSHCK-së që në fillim ka qenë gjetja e një zgjidhje për marrjen në trajtim të lëndëve të cilave në mungesë kourumi ju kishte skaduar afati i vendimmarrjes në KPMSHCK.

KPMSHCK pas konsultimeve të bëra me akterët e nevojshëm në mbledhjen e mbajtur me datë: 09.11.2020, kishte marr vendim për zgjidhjen e të gjitha lëndëve që ju kishte skaduar afati i vendimmarrjes dhe gjatë kësaj periudhe. Këshilli prej ankesave të pranuar në vitin 2020 dhe atyre të bartura nga vitet paraprake(2018,2019) ka vendosur për 241 ankesa, e që ka qenë një angazhim jashtëzakonisht i madh i anëtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë, duke punuar edhe jashtë orarit dhe gjatë vikendeve me qëllim që të rikthehet besimi te Këshilli, si institucion kryesor në vend për mbrojtje të ligjshmërisë në procese të ndryshme që lidhen me shërbim civil.

Pas fillimit të zgjidhjes së të gjitha lëndëve të cilave ju kishte skaduar afati i vendimmarrjes dhe shumica e palëve kishin hapur konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, shumë palë na janë drejtuar me shkresa që kanë shpreh shqetësime se po ndërhyjmë ose po ndikojmë me vendimin tonë në procedurën gjyqësore. Me qëllim që mos të shkaktohet pasiguri juridike KPMSHCK në mbledhjen e mbajtur me datë 15.01.2021, kishte marr vendim për **PEZULLIMIN** e përkohshëm për zgjidhjen e lëndëve të cilave ju kishte skaduar afati i vendimmarrjes në KPMSHCK.

Pas një bashkëpunimi të sinqertë dhe të vazhdueshëm me Gjykatën Themelore/Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha akteve juridike të zbatuara në Kosovë, KPMSHCK në mbledhjen e mbajtur me datë: 24.02.2021, duke u bazuar në nenin 32 të Kushtetutës së Kosovës si akti më i lartë juridik në vend dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut e zbatuar direkt, ka marr vendim që të zgjidhë të gjitha lëndët e palëve të cilat nuk ka hapur konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, ndërsa të gjitha palët që kanë shkuar në gjykatën kompetente, gjykata tashmë ka vendosur me aktvendim që t'i kthej për

rivendosje në KPMSHCK.

Momentalisht në KPMSHCK vazhdon puna për zgjidhjen e ankesave të palëve të cilat nuk kanë hapur konflikt administrativ, ankesave të cilat i ka kthyer gjykata në rivendosje e të cilat nuk kanë vendim të KPMSHCK-së dhe ankesave të rregullta që parashtrihen nga palët dhe të cilat zgjidhen në kuadër të afatit ligjor.

2. KORNIZA LIGJORE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kryen funksionet dhe përgjegjësitë në pajtim me:

- Kushtetutën e Republikës së Kosovës,
- Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (ka qenë në fuqi gjysmën e vitit 2020);
- Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë;
- Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
- Rregulloren Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
- Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
- Rregulloren Nr. 04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil;
- Rregulloren Nr. 05/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

3. FUSHËVEPRIMI I KËSHILLIT

Këshilli është organ i pavarur i cili mbikëqyrë respektimin e të gjitha rregullave dhe parimeve që rregullojnë Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, nga ana e institucioneve të administratës publike. Këshilli për punën e tij i raporton drejtpërdrejtë Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është paraparë me nenin 101 paragrafin 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ndërsa kompetenca dhe përgjegjësitë e tij janë të rregulluara me Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe duke ju referuar Aktgjykimit me Nr. Ref. AGJ.1363/19 të datës 20.05.2019 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, janë përcaktuar funksionet e Këshillit si në vijim:

- shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil.
- KPMSHCK në rast të mos zbatimit të vendimit të Këshillit, bazuar në ligjin e lartëshënuar nëse zyrtari përgjegjës nuk e zbaton vendimin e Këshillit, Këshilli shqipton sanksion administrativ duke ia ndalur pagën prej 50%, deri në momentin e zbatimit të vendimit.
- monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civilë, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Me qëllim të ushtrimit të funksioneve, Këshilli mund të:

- vizitojë çdo vend ku janë të punësuar nëpunësit civilë;
- të ketë qasje dhe të kontrollojë dosjet dhe çdo dokument lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil;
- të intervistojë çdo nëpunës civil, i cili mund të ketë informata që kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për ushtrimin e funksioneve të Këshillit;
- kërkon dhe merr nga institucionet çdo informacion të nevojshëm për kryerjen e detyrave të tij;
- organizon seanca profesionale; dhe
- nxjerr vendime, udhëzime qëndrime dhe rekomandime.


4.ORGANIZIMI I KËSHILLIT

Organizimi i brendshëm i Këshillit është i rregulluar me Ligjin Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe me Rregulloren Nr.05/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Me dispozitat e këtij Ligji është përcaktuar edhe përbërja e Këshillit, ku përcaktohet që Këshilli përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve, që emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në bazë të procedurave të hapura dhe transparente me mandat 7 vjeçar me pamundësi rizgjedhje, po ashtu përbërja e Këshillit pasqyron karakterin shumë etnik dhe gjinor të Republikës së Kosovës.

Sekretaria e Këshillit i ofron mbështetje administrative dhe profesionale-juridike Këshillit në ushtrimin e funksioneve kushtetuese dhe ligjore. Sekretaria udhëhiqet nga Sekretari i Përgjithshëm dhe ka të punësuar 23 nëpunës civilë. Në kuadër të Sekretarisë funksionon Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme dhe Divizioni për Mbështetje Profesionale.

Organogrami i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës



5. AKTIVITETET E KËSHILLIT PËR PËRIUDHËN RAPORTUESE

Në vijim të raportit, paraqesim një pasqyrim të plotë të aktiviteteve të Këshillit lidhur me ushtrimin e funksioneve të tij si:

Në raport përfshihen të dhëna lidhur me aktivitetet e kryera në kuadër të funksionit të shqyrtimit dhe vendosjes për ankesat e ushtruara nga nëpunësve civilë dhe nga kandidatët për punësim në shërbimin civil, ndërsa lidhur me funksionin e mbikëqyrjes së përzgjedhjes së nëpunësve të nivelit të lartë drejtues dhe atij drejtues, si dhe funksionin e monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil nga ana e institucioneve të vendit Këshilli nuk ka mundur të ushrojë asnjë aktivitet nga arsyet e potencuara më lartë.

5.1.FUNKSIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE

Këshilli gjatë vitit 2020 ka pranuar gjithsej 444 ankesa të cilat janë parashtruar nga nëpunësit civilë, si dhe nga kandidatët për praninë në shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

Këshilli, përveç 444 ankesave të pranuar në vitin 2020, në shqyrtim ka pasur edhe 844 ankesa, të cilat janë bartur nga vitet paraprake për vendosje në vitin 2020. Bazuar në këto të dhëna, rezulton që Këshilli gjatë vitit 2020 ka pasur në shqyrtim gjithsej 1288 ankesa.

Nga 1288 ankesa për shqyrtim gjatë vitit 2020, Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore për 241 ankesa, ndërsa 1047 ankesa kanë ngelur pa u vendosur brenda afatit ligjor, kjo për shkakun e mos emërimit të shtatë (7) anëtarëve të Këshillit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ky raport përmban të dhëna statistikore për ankesat e pranuar sipas:


1. objektit të ankesës,
2. strukturës gjinore të ankuesve,
3. strukturës etnike të ankuesve dhe
4. institucioneve ndaj vendimeve të të cilave është paraqitur ankesë.

5.1.1. Ankesat e pranuar sipas objektit të ankesës


Në Këshill, janë pranuar ankesa, të cilat kanë pasur objekt të ndryshëm të ankimimit dhe të ndara sipas llojit të objektit. Ndarja e ankesave sipas objektit pasqyrohet në numra dhe në përqindje në tabelën në vijim:

Tabela 1. Ankesat e pranuar sipas objektit të ankesës gjatë vitit 2020

Nr.	Objekti i ankesave	Numri i ankesave	Përqindja
1	Kërkesa nga marrëdhënia e punës	126	28.38%
2	Kompensim material	101	22.75%
3	Kontestim konkursi	70	15.77%
4	Masë disiplinore	45	10.13%
5	Ndërprerje e marrëdhënies së punës	26	5.86%
6	Shkelje e të drejtës në pagë	20	4.50%
7	Pezullim parandalues	19	4.28%
8	Transferime	18	4.05%
9	Vlerësim i punës	11	2.48%
10	Moszbatim i vendimeve të komisionit të ankesave	2	0.45%
11	Ulje në pozitë	2	0.45%
12	Mos vazhdim i kontratës së punës	2	0.45%
13	Pezullim i dakorduar	1	0.22%
14	Çështje të avancimit në karrierë	1	0.22%
	Gjithsej	444	100%



Diagrami 1. Paraqitja grafike e të dhënave të tabelës 1




Vazhdim i diagramit 1

5.1.2. Ankesat e ushtruara sipas strukturës gjinore të ankuesve

Nga 444 ankesa të pranuar në vitin 2020, ndarja sipas strukturës gjinore të ankuesve është si në vijim: ankues meshkuj kanë qenë 310 ose 69.82%, ndërsa ankuese femra kanë qenë 134 ose 30.18%.

Tabela 2. Ankesat e pranuar sipas strukturës gjinore të ankuesve

Nr. Rendor	Ankesat e ushtruara sipas strukturës gjinore	Numri	Përqindja
1	Meshkuj	310	69.82%
2	Femra	134	30.18%




Diagrami 2. Paraqitja grafike e të dhënave të tabelës 2

5.1.3. Ankesat e pranuar sipas strukturës etnike të ankuesve

Nga 444 ankesa të pranuar në vitin 2020, prej tyre 431 ose 97.07%, janë parashtruar nga ankuesit e përkatësisë etnikeshqiptare, ndërsa 11 ankesa ose 2.45%, janë parashtruar nga ankuesit e përkatësisë etnike serbe, 1 ankesë ose 0.22% është parashtruar nga ankuesit e përkatësisë etnike boshnjake, dhe 1 ankesë ose 0.22% është parashtruar nga ankuesit e përkatësisë etnike turke.

Tabela 3. Ankesat e pranuar sipas strukturës etnike të ankuesve

Nr.rendor	Ankesat e pranuar sipas strukturës etnike të ankuesve	Numri i ankesave	Përqindja
1	Shqiptar	431	97.07%
2	Serb	11	2.45%
3	Boshnjak	1	0.22%
4	Turk	1	0.22%




Diagrami 3. Paraqitja grafike e të dhënave të tabelës 3

5.1.4. Ankesat e pranuar sipas institucioneve kundër vendimeve të cilave është paraqitur ankesë

Këshilli, gjatë periudhës raportuese ka pranuar ankesa nga nëpunësit civilë dhe nga kandidatët për praninë në shërbimin civil, të parashtruara kundër vendimeve të organeve të punësimit, si në vijim: 338 ankesa ose 76.13% e numrit të përgjithshëm të ankesave janë parashtruar kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore si dhe 106 ankesa ose 24.10% e numrit të përgjithshëm të ankesave janë parashtruar kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale.

Tabela 4. Ankesat e pranuar sipas institucioneve kundër vendimeve të cilave është paraqitur ankesë

Nr.	Ankesat e pranuar sipas institucioneve kundër vendimeve të cilave është paraqitur ankesë	Numri i ankesave	Përqindja
1	Institucionet e administratës qendrore	338	76.13%
2	Institucionet e administratës lokale	106	23.87%



Diagrami 4. Paraqitja grafike e të dhënave tabelës 4

6. ANKESAT E PRANUARA KUNDËR VENDIMEVE TË INSTITUCIONEVE

6.1. Ankesat kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore

Këshilli, gjatë periudhës raportuese ka pranuar 338 ankesa kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore, të cilat pasqyrohen si në vijim:

Tabela 5. Të dhënat për numrin dhe përqindjen e ankesave të arritura në Këshill, gjatë vitit 2020, kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore.

Nr.	Institucionet e Administratës Qendrore	Numri i Ankesave	Përqindja
	Ministria e Punëve të Brendshme	30	6.76%
	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	29	6.53%
	Policia e Kosovës	27	6.08%
	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	26	5.85%
	Ministria e Infrastrukturës	16	3.60%
	Ministria e Drejtësisë	16	3.60%
	Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	14	3.15%
	Administrata Tatimore e Kosovës	13	2.93%
	Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit	13	2.93%

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	12	2.70%
Autoriteti i Aviacionit Civil	11	2.47%
Universiteti i Prishtinës	10	2.25%
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	9	2.02%
Zyra e Kryeministrit	8	1.80%
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	7	1.57%
Agjencia Pyjore e Kosovës	6	1.35%
Shërbimi Korrektues i Kosovës	6	1.35%
Agjencia Kosovare e Privatizimit	6	1.35%
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	6	1.35%
Universiteti i Mitrovicës	6	1.35%
Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore	5	1.12%
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	5	1.12%
Ministria e Financave	4	0.90%
Këshilli Prokurorial i Kosovës	4	0.90%
Agjencia e Statistikave të Kosovës	4	0.90%
Ministria e Integritetit Evropian	4	0.90%
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës	4	0.90%
Ministria e Shëndetësisë	4	0.90%
Ministria e Administratës Publike	3	0.67%
Gjykata Themelore në Prishtinë	3	0.67%
Institucioni i Avokatit të Popullit	3	0.67%
Akademia e Kosovës për Siguri Publike	2	0.45%
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	2	0.45%
Universiteti i Pejës	2	0.45%
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	1	0.23%
Gjykata Themelore në Prizren	1	0.23%
Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj	1	0.23%
Inspektorati i Punës	1	0.23%
Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë	1	0.23%
Universiteti i Gjilanit	1	0.23%
Komisioni i Pavarur për Media	1	0.23%
Organi Shqyrtues i Prokurimit	1	0.23%
Agjencia Kosovare për Produkte Medicinale	1	0.23%
Këshilli i Sigurisë së Kosovës	1	0.23%
Instituti Pedagogjik i Kosovës	1	0.23%
Agjencia për Ndihmë Juridike Falas	1	0.23%
Agjencia e Kosovës për Forenzikë	1	0.23%
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve	1	0.23%
Gjykata Themelore në Mitrovicë	1	0.23%
Inspektorati Policor i Kosovës	1	0.23%
Presidenca e Kosovës	1	0.23%
Qendra e Studenteve	1	0.23%
Gjithsej	338	76.13%

Tabela 6. Ankesat e pranuar kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore, sipas objektit të ankesave

Ankesat e pranuar kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore sipas objektit të ankesës	Kërkesa nga mardhënia e punës	Kompensim material	Kontestim Konkursi	Masë disiplinore	Ndërprerje e mardhënies së punës	Shkelje e të drejtës në pagë	Pezullim parandalues	Tranferime	Vlerësim i punës	Mos zbatim i vendimeve të komisioneve	Ullje në pozitë	Mos vazhdim i kontratës së punës	Cështje e avancimit në karrierë	Gjithsej
Ministria e Punëve të Brendshme	6	12	11		1									30
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	13	3	1	2	4	2	2		1		1			29
Policia e Kosovës	3	8		2		14								27
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	14			1	3		2	6						26
Ministria e Infrastrukturës	9	2		1	2			1	1					16
Ministria e Drejtësisë	4	2	1	7	1					1				16
Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	5	4	4										1	14
Administrata Tatimore e Kosovës	6	2		1	1			3						13
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit	7			2	1	1	2							13
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	3	3	2		1			1		1		1		12
Autoriteti i Aviacionit Civil	5			5	1									11
Universiteti i Prishtinës	1	8		1										10
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	2	4	2			1								9
Zyra e Kryeministrit	4	1					2	1						8
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit		3	4											7

Agjencia Pyjore e Kosovës			4	1				1				6
Shërbimi Korrektues i Kosovës	1		1	1	1		1		1			6
Agjencia Kosovare e Privatizimit	1	1					4					6
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	1		4		1							6
Universiteti i Mitrovicës			6									6
Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore	5											5
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	2		1		1		1					5
Ministria e Financave	3			1								4
Këshilli Prokurorial i Kosovës	1		1				1		1			4
Agjencia e Statistikave të Kosovës	3				1							4
Ministria e Integritetit Evropian				1	1				2			4
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës	2								2			4
Ministria e Shëndetësisë			3	1								4
Ministria e Administratës Publike		2	1									3
Gjykata Themelore në Prishtinë	2		1									3
Institucioni i Avokatit të Popullit	2								1			3
Akademia e Kosovës për Siguri Publike	1	1										2
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale			2									2
Universiteti i Pejës				2								2
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor		1										1
Gjykata Themelore në Prizren		1										1
Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj		1										1
Inspektorati i Punës		1										1
Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë	1											1
Universiteti i Gjilanit			1									1

Komisioni i Pavarur për Media	1														1
Organi Shqyrtues i Prokurimit			1												1
Agjencia Kosovar për Produkte Medicinale	1														1
Këshilli i Sigurisë së Kosovës				1											1
Instituti Pedagogjik i Kosovës		1													1
Agjencia për Ndihmë Juridike Falas		1													1
Agjencia e Kosovës për Forenzikë									1						1
Autoriteti Kombëtarë i Kualifikimeve		1													1
Gjykata Themelore në Mitrovicë			1												1
Inspektorati Policor i Kosovës									1						1
Presidenca e Kosovës							1								1
Qendra e Studentve		1													1
Gjithsej	109	64	48	33	21	18	16	12	11	3	1	1	1	1	338

6.2. Ankesat e pranuar kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka pranuar 106 ankesa të cilat janë parashtruar kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale, e të cilat pasqyrohen si në vijim:

Tabela 7. Të dhënat për numrin dhe përqindjen e ankesave të pranuar në Këshill, gjatë vitit 2020, kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale

Nr.	Institucionet e administratës	Numri i ankesave	Përqindja
1	Komuna e Prishtinës	19	4.28%
2	Komuna Malishevës	13	2.93%
3	Komuna e Prizrenit	11	2.48%
4	Komuna e Podujevës	7	1.58%
5	Komuna e Drenasit	6	1.35%
6	Komuna e Obiliqit	6	1.35%
7	Komuna e Ferizajt	5	1.13%
8	Komuna e Mitrovicës	4	0.90%
9	Komuna e Gjilanit	4	0.90%
10	Komuna e Pejës	4	0.90%
11	Komuna e Parteshit	4	0.90%
12	Komuna e Gjakovës	3	0.67%
13	Komuna e Rahovecit	3	0.67%
14	Komuna e Lipjanit	3	0.67%
15	Komuna e Kamenicës	2	0.45%
16	Komuna e Klinës	2	0.45%
17	Komuna Skenderajt	2	0.45%
18	Komuna Vushtrrisë	2	0.45%
19	Komuna Hanit të Elezit	2	0.45%
20	Komuna e Istogut	1	0.22%
21	Komuna e Kaçanikut	1	0.23%
22	Komuna e Shtimes	1	0.23%
23	Komuna e Shtërpçës	1	0.23%
	Gjithsej	106	23.87%

Tabela 8. Ankesat e pranuar kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale sipas objektit të ankesave

Ankesat e pranuar kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale sipas objektit të ankesave	Kontestim konkursi	Kompensim material	Ndërpërje e marrëdhënies së bashkëpunimit	Transferim	Masë disiplinore	Pezullim parandalues	Shkelje e të drejtës në pagë	Kërkesa nga marrëdhënia e punës	Vlerësim i punës	Ujje në pozitë	Pezullim i dakorduar	Gjithsej
Komuna e Prishtinës	2	8	2	1	1	1			3		1	19
Komuna e Malishevës	2	10		1								13
Komuna e Prizrenit	2	2	1		1	2	1	2				11
Komuna e Podujevës	2	2			1			2				7
Komuna e Drenasit	1	2		1	1		1					6
Komuna e Obiliqit	3	1			1			1				6
Komuna e Ferizajt	1	1		1	1			1				5
Komuna e Mitrovicës	1			1	2							4
Komuna e Gjilanit	3				1							4
Komuna e Pejës	2	1	1									4
Komuna e Parteshit		4										4
Komuna e Gjakovës								3				3
Komuna e Rahovecit		1			1			1				3
Komuna e Lipjanit	1	2										3
Komuna e Kamenicës					1			1				2
Komuna e Klinës		1						1				2
Komuna Skenderajt		2										2
Komuna e Vushtrrisë				1						1		2
Komuna e Hanit të Elezit	2											2
Komuna e Istogut								1				1
Komuna e Kaçanikut			1									1
Komuna e Shtimes					1							1
Komuna e Graçanicës								1				1
Gjithsej	22	37	5	6	12	3	2	14	3	1	1	106

7.NDARJA E ANKESAVE SIPAS MËNYRËS SË VENDOSJES

Këshilli, gjatë vitit 2020, ka shqyrtuar dhe ka vendosur për gjithsej 241 ankesa, si në vijim:

7.1. Të aprovuara

Janë ankesat e parashtruara nga ankuesit, që në bazë të provave dhe fakteve, Këshilli i ka aprovuar dhe ka anuluar vendimet e organeve të punësimit, duke i obliguar organet e punësimit për zbatimin e vendimeve të Këshillit në afatin e përcaktuar ligjor.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka aprovuar **(56)** ankesa.

7.2. Pjesërisht të aprovuara

Janë ankesat e parashtruara nga ankuesit, të cilat kanë dy e më shumë pretendime ankimore dhe për të cilat Këshilli në bazë të provave dhe fakteve të ofruara nga ankuesit dhe nga organet e punësimit ka vendosur për aprovimin e pjesërisht të ankesës.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka aprovuar pjesërisht **(21)** ankesa.

7.3. Të refuzuara

Janë ankesat e parashtruara nga ankuesit, të cilat Këshilli i ka refuzuar si të pabazuara në bazë të provave dhe fakteve të paraqitura nga ankuesit dhe organet e punësimit, duke lënë në fuqi vendimet e organeve të punësimit.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka refuzuar **(79)** ankesa.

7.4. Të hedhura poshtë si të palejuara

Janë ankesat e parashtruara nga ankuesit, të cilat Këshilli i ka hedhë poshtë si të palejuara, sepse nuk janë shterur mjetet e brendshme të ankimit, janë parashtruar jashtë afatit të përcaktuar ligjor për ankim, apo janë parashtruar nga personat që në bazë të ligjit nuk konsiderohen palë në procedurë. Këshilli gjatë periudhës raportuese ka hedhur poshtë si të palejuara **(28)** ankesa.

7.5. Të shpallura jo-kompetent

Janë ankesat e parashtruara nga ankuesit, për të cilat Këshilli ka vendosur që të shpallet jo-kompetent, për shkak se ankesat janë parashtruar nga personat të cilët nuk e kanë statusin e nëpunësit civil ose nuk janë kandidatë për pranim në shërbimin civil.

Këshilli gjatë periudhës raportuese është shpallur jo kompetent për **(20)** ankesa.

7.6. Detyrimi i organit administrativ për të nxjerr aktin administrativ

Janë vendime me të cilat Këshilli i detyron organet e punësimit, respektivisht komisionet përkatëse për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave për të vendosur për ankesën e ankuesit, në rastet kur nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka nxjerr vendime për detyrimin e organeve të punësimit për të vendosur, për **(9)** ankesa.

7.7. Kthimi në rishqyrtim

Janë vendime me të cilat, Këshilli ka vendos për kthimin e lëndës në rishqyrtim tek organet e punësimit për të gjitha rastet kur në bazë të provave dhe fakteve të ofruara nga ankuesit dhe nga organet e punësimit, Këshilli ka konstatuar se nëse lënda kthehet në rishqyrtim tek organi i punësimit do të evitohen gabimet të cilat nuk konsiderohen si shkelje të rënda procedurale. Këshilli gjatë periudhës raportuese ka vendosur për kthimin e lëndës në rishqyrtim për **(8)** ankesa.


7.8. Përfundim i procedimit administrativ

Janë vendime të cilat Këshilli i nxjerr për të gjitha rastet kur ankuesit i tërheqin ankesat ose kur Këshilli konstaton se objekti për të cilin kishte filluar procedimi ose qëllimi i vendimit është bërë i pamundur. Këshilli gjatë periudhës raportuese ka vendosur për përfundimin e procedimit administrativ për **(20)** ankesa.

Në vijim paraqitet në mënyrë tabelare, mënyra e vendosjes nga Këshilli për **241** ankesa, numri i ankesave të vendosura si dhe përqindja në krahasim me numrin e përgjithshëm të ankesave të vendosura.

Tabela 9. Mënyra e vendosjes së ankesave nga Këshilli, numri i ankesave sipas mënyrës së vendosjes dhe përqindja në krahasim me numrin e përgjithshëm të ankesave

Mënyra e vendosjes	Numri i ankesave	Përqindja
Të refuzuara	79	32.78%
Të aprovuara	56	23.23%
Të hedhura poshtë si të palejuara	28	11.62%
Të aprovuara pjesërisht	21	8.71%
Shpallja jo kompetent	20	8.30%
Përfundim i procedimit administrativ	20	8.30%
Detyrim për vendosje	9	3.73%
Kthimi në rishqyrtim	8	3.32%
Gjithsej	241	100%



Diagrami 5. Paraqitja grafike e të dhënave të tabelës 9

8. FORMAT E VENDOSJES KUNDËR VENDIMEVE TË INSTITUCIONEVE

Në këtë pjesë të raportit, paraqiten të dhënat për formën e vendosjes nga Këshilli, lidhur me ankesat e parashtruara kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore dhe lokale.

8.1. Format e vendosjes kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore

Këshilli, gjatë periudhës raportuese ka vendosur për **173** ankesa të parashtruara kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore, gjegjësisht për **101** ankesa të vitit 2020, dhe për **72** ankesa të bartura nga vitet paraprake në vitin 2020.

Tabela 10. Format e vendosjes për ankesat e shqyrtuara dhe të vendosura gjatë vitit 2020 kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore

Institucionet e Administratës Qendrore	Të Aprovuara	Të refuzuara	Pjesërisht të aprovuara	Të hedhura poshtë si të palejuara	Shpallja jo kompetent	Kthimi në rishqyrtim	Përfundim prtocedimi	Detyrimi i organit administrativ për të nxjerr aktin administrativ	Numri i ankesave të shqyrtuara
Ministria e Punëve të Brendshme	7	3	1	2		3	3	1	20
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	3	2	13	1		1			20
Ministria e Infrastrukturës	2	6		1			1		10
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit	1	1			6	1			9
Agjencia Kosovare e Privatizimit	2	4	2						8
Ministria e Drejtësisë	5	1		2					8
Ministria e Financave	3	4							7
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës				1	1	3		2	7
Shërbimi Korrektues i Kosovës		1	3	1			1		6
Agjencia e Statistikave të Kosovës		3		2	1				6
Autoriteti i Aviacionit Civil	2			2			1	1	6
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	1	1	1					2	5
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	1			2			1	1	5
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	1	1		2					4
Policia e Kosovës	1	2		1					4
Ministria e Shëndetësisë	1	1					1		3

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	2						1		3
Administrata Tatimore e Kosovës	1	1					1		3
Ministria e Administratës Publike		2							2
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural		1			1				2
Universiteti i Pejës				1				1	2
Gjykata Themelore në Prizren	1	1							2
Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror		1			1				2
Agjencia Pyjore e Kosovës	2								2
Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës		2							2
Kuvendi i Republikës së Kosovës				2					2
Akademia e Kosovës për Siguri Publike			1	1					2
Agjencia e Punësimit		1		1					2
Ministria e Punëve të Jashtme					1				1
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor							1		1
Zyra e Kryeministrit		1							1
Këshilli i Sigurisë së Kosovë	1								1
Qendra e Studentëve të UP-së		1							1
Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj				1					1
Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës		1							1
Organi Shqyrtues i Prokurimit	1								1
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Gjakovë					1				1
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale		1							1
Biblioteka Kombëtare e Kosovës							1		1
Muzeu i Kosovës							1		1
Agjencia Kadastrale e Kosovës		1							1
Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuara				1					1
Agjencia e Shoqërisë së Informacionit							1		1
Gjykata e Apelit në Prishtinë		1							1
Gjykata Supreme e Kosovës		1							1
Gjykata Themelore në Prishtinë		1							1
Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë		1							1
Gjithsej	38	48	21	24	12	8	14	8	173

8.2. Format e vendosjes së ankesave kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale

Këshilli, gjatë periudhës raportuese ka vendosur për 68 ankesa të parashtruara kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale, ku 33 Ankesa janë të viti 2020 dhe 35 ankesa të bartura nga vitet paraprake.

Tabela 11. Format e vendosjes për ankesat e shqyrtuara dhe të vendosura gjatë vitit 2020 kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale

Institucionet e Administratës Lokale	Të aprovuara	Të refuzuara	Të hedhura poshtë si të palejuara	Shpallja jo kompetent	Përfundim i procedimit administrativ	Detyrimi i organit administrativ për të nxjerr	Numri i ankesave të shqyrtuara
Komuna e Prishtinës	2	10		1			13
Komuna e Prizrenit	1	9		1			11
Komuna e Mitrovicës	2	2			1	1	6
Komuna e Obiliqit	2	1	1	1			5
Komuna e Ferizajt	1			1	1		3
Komuna e Podujevës	1	2					3
Komuna e Malishevës	1	1		1			3
Komuna e Gjilanit	2		1				3
Komuna e Klinës		1			1		2
Komuna e Pejës	1				1		2
Komuna e Drenasit	1	1					2
Komuna e Rahovecit		1	1				2
Komuna e Graçanicës	1				1		2
Komuna e Klllokotit	2						2
Komuna e Istogut					1		1
Komuna e Kamenicës				1			1
Komuna e Shtërpces				1			1
Komuna e Shtimes		1					1
Komuna e Skenderajt			1				1
Komuna e Lipjanit		1					1
Komuna e Gjakovës	1						1
Komuna e Hanit të Elezit		1					1
Komuna e Vitisë				1			1
Gjithsej	18	31	4	8	6	1	68

9. ZBATIMI I VENDIMEVE TË KËSHILLIT NGA ORGANET E PUNËSIMIT

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, organet e punësimit që kanë të punësuar nëpunës civilë janë të obliguara për zbatimin e vendimeve të Këshillit.

Vendimet e Këshillit janë vendime administrative të formës së prerë dhe duhet të zbatohen nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që ka nxjerrë vendimin e parë ndaj palës.

Moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i institucionit paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës sipas Ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës.

Organet e punësimit për vitin 2020, kanë pasur obligim ligjor për të zbatuar 94 vendime të Këshillit, prej tyre 77 vendime përfundimtare dhe 17 vendime të ndërmjetme, si në vijim:

- **56** vendime përfundimtare me të cilat janë aprovuar ankesat;
- **21** vendime përfundimtare me të cilat janë aprovuar pjesërisht ankesat;
- **9** vendime të ndërmjetme me të cilat organet e punësimit janë obliguar që të nxjerrin aktin administrative; dhe
- **8** vendime të ndërmjetme me të cilat organet e punësimit janë obliguar që të rishqyrtojnë vendimet e tyre.


Përkundër faktit që vendimet e Këshillit janë vendime të formës së prerë në procedurë administrative, nga njoftimet që Këshilli ka pranuar nga organet e punësimit dhe ankuesit rezulton që organet e punësimit nga 77 vendime përfundimtare.

janë zbatuar.....	66 vendime,
nuk janë zbatuar.....	3 vendime,
në process të zbatimit janë	5 vendime,
me vendime të Gjykatës janë pezulluar.....	3 vendime.

Ndërsa nga 17 vendime të ndërmjetme janë zbatuar:.....	9 vendime,
Nuk është zbatuar	1 vendim
Në proces të zbatimit janë	7 vendime

Tabela 12. Numri i ankesave për vendimet përfundimtare, vendimet e zbatuara, vendimet e pazbatuara si dhe vendimet e pezulluara me vendim të gjykatës


Vendimet e Këshillit për ankesat	Numri i vendimeve për zbatim	Vendimet e zbatuara	Vendimet e pa zbatuara	Vendime ne proces te zbatimit	Numri i vendimeve të pezulluara me vendim të Gjykatës
Të aprovuara	56	47	3	3	3
Pjesërisht të aprovuara	21	19	0	2	0
Gjithsej	77	66	3	5	3



Diagrami 6. Paraqitja grafike e të dhënave të tabelës 12

Tabela 13. Numri i vendimeve te ndërmjetme, vendimet e zbatuara, vendimet e pazbatuara si dhe vendimet e pezulluara me vendim të gjykatës

Vendimet e Këshillit ankesat për	Numri i vendimeve për zbatim	Vendimet e zbatuara	Vendim i pa zbatuar	Vendime ne proces të zbatimit	Numri i vendimeve të pezulluara me vendim të Gjykatës
Detyrim për vendosje	9	2	0	7	0
Kthimi në rishqyrtim	8	7	1	0	0
Gjithsej	17	9	1	7	0



Diagrami 7. Paraqja grafike e të dhënave të tabelës 13

Institucionet që nuk i kanë zbatuar vendimet e Këshillit janë si më poshtë:

Tabela 14. Institucionet që nuk i kanë zbatuar vendimet e Këshillit si dhe numrin e vendimeve të pa zbatuara

Nr.	Institucionet e administratës qendrore	Numri i vendimeve të pazbatuara	Numri referues i vendimit	Personi përgjegjës për zbatim
1	Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë	1	A.nr.275/2020	Ministri
2	Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë	1	A.nr.397/2020	Ministri
3	Ministria e Shendetësisë	1	A.nr.713/2019	Sekretari
4	Ministria e Infrastruktues	1	A.nr.77/2019	Sekretari
	Gjithsej	4		

10. FUNKSIONI I MBIKËQYRJES SË PËRZGJEDHJES SË NËPUNËSVE TË NIVELIT TË LARTË DREJTUES DHE TË NIVELIT DREJTUES

Po ashtu lidhur me kete funksion Këshilli për shkaqe të cekura më larte nuk ka mundur që të ushtroj asnjë aktivitet.

11. FUNKSIONI I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

Po ashtu lidhur me kete funksion Këshilli për shkaqe të cekura më larte nuk ka mundur që të ushtroj asnjë aktivitet.

12. REKOMANDIMET DHE SFIDAT E KËSHILLIT

1. Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës rekomandon Kuvendin e Kosovës që me urgjencë të ndërmer veprime për plotësimin e Ligjit për Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse ka vështërsi të thekësuar në zbatimin e tij në praktikë, gjithashtu edhe Gjykata Kushtetuese me Aktgjykimin Nr. Ref.: AGJ 1583/20 ka shfuqizuar dispozita të këtij ligji dhe njëherit ka kërkuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që ta plotësoj dhe ndryshoj ligjin e lartëshenuara.

2. Sigurimi i një objekti me hapësirë të mjaftueshme për punë efikase të këshillit, sepse aktualisht nuk kemi as kushte minimale për punë efikase. Ne kemi një ambient shumë të papërshtatshëm për punë profesionale dhe kemi vetëm një zyrë ku punojnë disa bashkëpunëtorë profesionalë si dhe një zyrë që punojnë disa zyrtarë administrativë, ku me asnjë rregull nuk parashihet që kjo të jetë formë efikase dhe kualitative e punës, e që na pamundëson që të ushtrojmë në mënyrë efikase të gjitha përgjegjësitë që parashihen me legjislacionin në fuqi, si p.sh. organizimi i trajnimeve, seancave profesionale, seancave dëgjimore, etj.

3. Përfshirja e KPMSHKC-së në grupe punuese që lidhen me çështje të shërbimit civil.

4. Pagat e nëpunësve administrativë të KPMSHCK-së të jenë ekuivalente me pagat e nëpunësve administrativë të Kuvendit të Kosovës.

5. Të lejohet të ketë rekrutim shtesë të stafit profesional dhe administrativ, gjë që është e domosdoshme, pasi që na janë shtuar shumë përgjegjësi dhe kompetenca dhe me këtë staf aktual është problem që në afate ligjore të i kryejme të gjitha obligimet ligjore.

Për shkak të mos funksionimit të KPMSHCK-së gjatë vitit 2019 dhe 2020 rekomandimit e KPMSHCK më tepër janë teknike se sa përmbajtësore në fushën profesionale që e mbulon KPMSHCK.

13. VENDIMET E GJYKATAVE

Deri me datë 31.12.2020 nga gjykata themelore/Departamenti për çështje Administrative Këshilli ka pranuar 82 Aktvendime për të dhënë përgjigje në paditë e ushtruara kundër vendimeve të KPMSHCK-së .

Nga dt 01.01.2020 e deri me datë 31.12.2020 nga gjykatat e vendit kemi pranuar 109 vendime, (Aktgjykime dhe Aktvendime).

Nga dt 01.01.2020 e deri me datë 31.12.2020 nga Gjykata Themelore kemi pranuar 187 ftesa për seanca gjyqësore.

Më poshtë gjeni të dhënat e detajuara për vendimet (aktgjykimet dhe aktvendimet) e pranuar për vitin 2020.

Nga Gjykata Themelore në vitin 2020 kemi pranuar gjithsej 69 vendime, nga të cilat 52 aktgjykime dhe 17 aktvendime.

Aktgjykimet e Gjykatës Themelore janë si vijon:

1. Me 6 Aktgjykime janë Aprovuar paditë dhe janë anuluar 6 vendime të KPMSHCK
2. Me 34 Aktgjykime janë refuzuar 34 paditë dhe janë vërtetuar 34 vendime të KPMSHCK – 34 vendime;
3. Me 10 Aktgjykime janë aprovuar padia e paditësve dhe lëndët janë kthyer në rishqyrtim tek Këshilli;
4. Me 2 Aktgjykime janë hedhur poshtë paditë si të Jasht afatshme.

Aktvendimet e Gjykatës themelore janë si vijon:

1. Me 3 aktvendime janë hedhur poshtë paditë e ushtruara dhe janë vërtetuar vendimet e Keshillit.
2. Me 9 aktvendime janë pezulluar 9 procedura Gjyqesore.
3. Me 1. Aktvendim është lejuar Përmbarimi i vendimit të Këshillit.
4. Me 1 aktvendim lënda është kthyer në gjendje të mëparshme.
5. Me 1 aktvendim është shtyrë ekzekutimi i vendimit të Këshillit.
6. Me 1 aktvendim është refuzuar si e palejuar kërkesa per shtyrje te ekzekutimit te vendimit të Këshillit.
7. Me 1 aktvendim është refuzuar kërkesa për përjashtimin e Gjyqtares nga procedura.

Nga Gjykata e Apelit në vitin 2020 kemi pranuar 16 aktgjykime dhe 11 aktvendime.

Aktgjykimet e pranuar nga Gjykata e Apelit për vitin 2020 janë si vijon:

1. Me 15 Aktgjykime janë Refuzuar 15 padi te e ushtruara kundër vendimeve te Keshillit.
2. Me (1)nje aktgjykim është refuzua ankesa e KPMSHCK

Aktvendimet e pranuar nga Gjykata e Apelit për vitin 2020 janë si vijon:

1. Aprovohet ankesa e KPMSHCK, anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe lënda kthehet në rishqyrtim në Gjykatën Themelore – 1 vendim;
2. Aprovohet ankesa e institucionit, anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe lënda kthehet në rishqyrtim në Gjykatën Themelore – 1 vendim;
3. Refuzohet ankesa (padia) vërtetohet vendimi i Gjykatës Themelore – 8 vendime.

Nga Gjykata Supreme për vitin 2020 kemi pranuar gjithsejtë 13 vendime:

1. Refuzohet ankesa e paditësit – 11 vendime;
2. Aprovohet ankesa dhe lënda kthehet në rishqyrtim – 1 vendim dhe
3. Një aktvendim me të cilin hedhet poshtë ankesa.

14. BASHKËPUNIMI I KËSHILLIT ME INSTITUCIONET TJERA

Edhe pse në mungesë të pesë anëtarëve ne jemi munduar të bashkëpunojmë me të gjitha institucionet relevante.

15. KRAHASIMI I PUNËS SË KËSHILLIT PËR VITIN 2020 ME PUNËN E KËSHILLIT PËR VITIN 2019

15.1. Funkzioni i shqyrtimit të ankesave

Në tekstin në vijim do të paraqiten të dhënat për punën e Këshillit për vitin 2020 në krahasim me punën e Këshillit për vitin 2019, në pajtim me kërkesën dhe formatin e raportit të punës.

Në vitin 2020 në Këshill janë pranuar gjithsej 444 ankesa, kurse në vitin 2019 në Këshill janë pranuar 784 ankesa. Nga kjo e dhënë, konstatohet që në Këshill gjatë vitit 2020 janë pranuar 340 ankesa më pak se ankesat e pranuar në vitin 2019.

Këshilli, gjatë vitit 2020 ka pasur në shqyrtim 1288 ankesa dhe prej tyre ka vendosur për 241 ankesa, në krahasim në vitin 2019 kur ka pasur në shqyrtim 896 ankesa, prej të cilave ka vendosur për 49 ankesa. Nga kjo rezulton që Këshilli gjatë vitit 2020 ka vendosur për 192 ankesa me shumë se sa në vitin 2019.

Këshilli gjatë vitit 2020 ka pasur në shqyrtim 1288 ankesa, ndërsa në vitin 2019 ka pasur në shqyrtim 896 ankesa. Nga kjo rezulton se Këshilli gjatë vitit 2020 ka pasur në shqyrtim 392 ankesa më shumë se në vitin 2019.

Në vitin 2020 organet e punësimit kanë pasur për obligim zbatimin e 94 vendimeve të Këshillit, prej 94 vendimeve, organet e punësimit kanë zbatuar 73 vendime, nuk kanë zbatuar 4 vendime, ndërsa në proces të zbatimit janë edhe 14 vendime, dhe 3 vendime janë pezulluar me vendim të gjykatës.

Tabela 16. Krahasimi i ankesave të pranuar, ankesave në shqyrtim si dhe vendimet e nxjerra gjatë vitit 2020 dhe 2019

Nr.	Ankesat/Vendimet	Viti 2020	Viti 2019	Ndryshimi	Krahasimi i ankesave dhe vendimeve në mes të vitit 2020 dhe 2019
1.	Ankesat e pranuar	444	784	340	Këshilli në vitin 2020 ka pranuar 340 ankesa më pak se në vitin 2019
2.	Ankesat për shqyrtim në Këshill	1288	896	392	Këshilli në vitin 2020 ka pasur në shqyrtim 392 ankesa më shumë se në vitin 2019
3.	Ankesat e shqyrtuara në Këshillit (Numri i vendimeve)	241	49	192	Këshilli në vitin 2020 ka nxjerrë 192 vendime më shumë se në vitin 2019
4.	Vendimet e obligueshme për zbatim	94	20	74	Organet e punësimit në vitin 2020 kanë pasur obligim për zbatimin e 94 vendimeve, ndryshimi nga viti 2020 vitin 2019 është për 74 vendime.
5.	Vendimet e zbatuara	73	17	56	Numri i vendimeve të zbatuara është 73
6.	Vendimet e pazbatuara	4	2	2	Në vitin 2020 kanë qenë 4 vendime të pazbatuara

15.2. Funkzioni i monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil

Nuk është realizuar asnjë vizitë lidhur me respektimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil të Kosovës për shkaqet e lartëshënuara.

16. RAPORTI PËR SHPENZIMIN E BUXHETIT TË KËSHILLIT

Buxheti fillestar i aprovuar për Këshillin, sipas Ligjit 07/L-001, në total ka qenë: 384.151.00 Euro dhe Ligjit të rishikuar 07/L-014 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, ka qenë në shumën prej: 362.561.00 Euro.

Sipas ligjit buxheti i Këshillit është ndarë në këto kategori ekonomike si në tabelën 17.

Tabela 17. Ndarja dhe alokimi i mjeteve sipas kategorive ekonomike

Nr	Kategoritë Ekonomike	Buxheti fillestar aprovuar sipas Ligjit 06/L-133 A	Buxheti i rishikuar sipas ligjit nr, L-07/L-014 B	Ndryshimi C=A-B	Buxheti Final-SIMFK D=B
1	Paga dhe mëditje	268,836.00	268,836.00	00	268,836.00
2	Mallra dhe shërbime	111,490.00	91,490.00	20,000.00	91,490.00
3	Shpenzime komunale	3,825.00	2,235.00	1,590.00	2,235.00
4	Shpenzime kapitale	00	00	00	00
	Totali	384,151.00	362,561.00	21,590.00	362,561.00

Nga tabela 17 shihet qartë se ka dallim (ndryshim) në mes të buxhetit fillestar dhe buxhetit final si SIMFK.

Nga pasqyra e cekur më lartë, shohim se ka ndryshim në mes buxhetit fillestar (ndarja) dhe buxhetit final (SIMFK), në shumë prej: 21,590.00 euro. Ky ndryshim ka ndodhë si vijon:

Në kategorinë **Mallra dhe Shërbime**, Këshillit ju ka shkurtuar buxheti në shumë prej:.....20.000.00€

Në kategorinë **Shpenzime Komunale**, Këshillit ju ka shkurtuar buxheti në shumë prej:..... 1,590.00€

Këshilli gjatë vitit 2020, ka pas një **kursim** të mjeteve në shume prej: 81,601.43€, ky kursim ka qenë si rrjedhojë e mos kompletimit të Këshillit me (7) anëtarë, nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Qeveria me vendim nr.,07 dhe 09/2020 datë 21.12.2020, Këshillit ia ka marrë shumën e mjeteve të kursyera në total: **81,601.43euro**, si vijon:

Nga kategoria Paga dhe shtesa mjete në shumë.....73,316.42€

Nga kategoria Mallra dhe shërbime, mjete në shumë.....8,285.01€

Kjo pasqyrohet në tabelën e mëposhtme **nr.18**

Tabela 18. Shpenzimet e buxhetit sipas kategorive ekonomike

Nr.	Kodi buxhetor 249	Buxheti final 2020	Buxh.i zvogëluar Me vendim Qev.	Buxheti si në SIMFK	Buxheti i shpenzuar	Të shprehura në %
1	Paga dhe mëditje	268,836.00	73,316.42	195,519.58	194,469.58	99.46%
2	Mallra dhe shërbime	91,490.00	8,285.01	83,204.99	77,977.89	93.72%
3	Shpenzime komunale	2,235.14	00	2,235.14	1,606.43	71.87 %
4	Shpenzime kapitale	00	00	00	00	00
	Totali	362,561.14	81,601.43	280,959.71	273,928.90	97.50%

Gjatë vitit 2020, nga buxheti si në SIMFK, Këshilli ka shpenzuar në total: 97,50 % të buxhetit. Buxheti i shpenzuar në kategoritë ekonomike është si vijon:

Në kategorinë ekonomike Paga dhe Mëditje: Buxheti është shpenzuar në masën prej: 99.46%.

Në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime: Buxheti është shpenzuar në masën... 93.72%.

Në kategorinë ekonomike Shpenzime komunale: Buxheti është shpenzuar në masën.. 71.87 %.

P.S. Ky Raport nuk është Aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.